

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7142  
E premte, 15 mars 2024  
Çmimi 0.50

## Escobari shkon në Pejë dhe Deçan



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



# OPOZITA KOMENTON VENDIMIN E QEVERISË PËR TOKËN E MANASTIRIT TË DEÇANIT: KURTI ME KAUZA TË RRËJSHME ERDHI NË PUSHTET.

FAÇE 4-5



Tri partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), kanë komentuar të enjten vendimin e qeverisë Kurti për

dhënien e 24 hektarëve tokë Manastirit të Deçanit. Liderët e partive opozitare, Memli Krasniqi, Lumir Abdixhiku dhe Ramush Haradinaj, kanë theksuar se Kurti me kauza të rrejshme erdhi në pushtet. Sipas

tyre, ka qenë vetë kryeministri Kurti që dikur e ka kualifikuar tradhti një vendim të tillë, duke anatemuar e sulmuar secilin protagonist politik të vendit tonë ndër vite, e sot vetë po i zbaton këto vendime

## AKTUALE



SHBA-ja NUK SHEH SHENJA SE RUSIA PLANIFIKON TË PËRDORË ARMË BËRTHAMORE F. 2

HAPET KONKURSI PËR KRIJIMIN E SHESHIT MONUMENTAL "ADEM JASHARI" NË PRISHTINË F. 6

GLPS-JA: PROJEKTILIGJI PËR ZYRTARËT PUBLIKË, NË KUNDËRSHTIM ME AKTGJYKIMIN E GJYKATËS KUSHTETUESE F. 7

## EKONOMI



ISMAILI: RREGULLORJA E BOK-së S'KRIJON PROBLEME, POR SHPËRFAQ VEPRIMET E KUNDËRLIGJSHME F. 8

"TERMOKOS"-I DO TA FILLOJË SHPËRNDARJEN E FATURAVE TESTUESE SIPAS KONSUMIT F. 8

## SPORT



DRITA SHËNON FITORE TË MADHE NDAJ FERONIKELIT, PRISHTINA DEKLASOI DUKAGJININ F. 10

**RAPORTI VJETOR I NATO-s: PRANIA E ALEANCËS NË KOSOVË, KYÇE PËR BALLKANIN** F. 3



**BALLKANI GODITET NGA NJË TËRMET I FUQISHËM, LËKUNDJET NDIHEN EDHE NË KOSOVË** F. 3



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçishtë - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mbl: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 870 | 045 500 870  
044 500 870 | 049 500 870

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## ShBA-ja nuk sheh shenja se Rusia planifikon të përdorë armë bërthamore

**UASHINGTON, 14 MARS** - Shtëpia e Bardhë tha të mërkurën vonë se nuk sheh ndonjë tregues se Moska është e gatshme të përdorë armë bërthamore në Ukrainë pas deklaratave të presidentit rus Vladimir Putin, se ai është i gatshëm ta bëjë këtë nëse kërcënohet sovraniteti i Rusisë. “Ne nuk kemi parë ndonjë arsye për ta përshtatur qëndrimin tonë bërthamor, as nuk kemi parë tregues se Rusia po përgatitet të përdorë armë bërthamore në Ukrainë”, tha zëdhënësjja e Shtëpisë së Bardhë, Karine Jean-Pierre.

Lideri rus ka folur vazhdimisht për gatishmërinë për të përdorur armë bërthamore prej se Moska e nisi pushtimin e Ukrainës në shkurt 2022.

Jean-Pierre shtoi se “retorika bërthamore e Rusisë” ka qenë “e pamatur” gjatë gjithë kohës prej se ajo e nisi pushtimin e Ukrainës.

Duke folur në një intervistë për televizionin shtetëror, e cila u publikua më 13 mars, Putini e përshkroi presidentin amerikan Joe Biden si një politikan veteran i cili i kupton rreziqet e mundshme të përshkallëzimit, dhe tha se nuk mendon se bota po shkon drejt një lufte bërthamore.

Në të njëjtën kohë, ai tha se forcat bërthamore të Rusisë janë në gatishmëri të plotë dhe se “nga pikëpamja tekniko-ushtarake, ne jemi të gatshëm”.

Putini tha se Moska është e gatshme të përdorë armë bërthamore në rast se kërcënohet “ekzistenca e shtetit rus, sovraniteti dhe pavarësia jonë”.

Një kërcënim të tillë ai e bëri edhe gjatë një fjalimi para kombit në shkurt, kur e paralajmëroi Perëndimin se thellimi i përfshirjes së tij në luftën në Ukrainë rrezikon nxitjen e një lufte bërthamore.



## Rusia ua ndalon hyrjen Cholletit dhe Millerit



**MOSKË, 14 MARS** - Rusia ua ka ndaluar hyrjen mbi 200 qytetarëve amerikanë, përfshirë edhe këshilltarit të lartë politik të Departamentit Amerikan të Shtetit, Derek Chollet, dhe zëdhënësit të këtij institucioni, Matthew Miller. Këto veprime të Moskës janë në shenjë hakmarrjeje për sanksionet e vendosura nga Uashingtoni ndaj rusëve për mbështetjen e tyre për pushtimin rus të Ukrainës.

Ministria e Jashtme e Rusisë tha përmes një deklaratë se 227 amerikanëve u është ndaluar hyrja në Rusi “sepse ata janë të përfshirë në hartimin, zbatimin dhe justifikimin e kursit rusofobik të administratës aktuale të Shteteve të Bashkuara si dhe janë të përfshirë drejtpërdrejt në veprimet kundër Rusisë”.

Lista, që tashmë numëron 2 078 persona, shënjestron përfaqësuesit e qeverisë amerikane, afaristët, gazetarët dhe akademikët.

Përveç Millerit, në listë janë përfshirë edhe ish-ambasadori amerikan në Rusi, John Sullivan, ish-sekretari i Thesarit, Lawrence Summers, zëvendëspërfaqësuesja për tregti, Sarah Bianchi dhe drejtori për çështje evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare, Alexander Vidman. Vidman, i lindur në Kiev, më herët kishte dëshmuar para Kongresit Amerikan lidhur me abuzimin e pushtetit në gjykimin e parë të presidentit të atëhershëm, Donald Trump. “Përveç se janë shpallur të padëshirueshëm në Federatën Ruse një numër i organizatave humanitare amerikane, që përdoren nga Ambasada Amerikane në Moskë për të rekrutuar ‘agjentë me

ndikim’, zgjerimi aktual i ‘listës së ndalimit’ synon, veç të tjerash, të konsolidojë ndërgjegjësimin e Uashingtonit për të vërtetën dhe për t’i treguar se çdo përpjekje agresive nuk do të kalojë pa u ndëshkuar”, u tha në deklaratë. Kjo ministri, po ashtu, akuzoi Austrinë “për hapin e radhës jomiqësor”, pasi Vjena dëboi dy diplomatë nga Ambasada e Rusisë në Austri.

Një ditë më herët Austria urdhëroi dy diplomatë rusë të largoheshin nga shteti, pasi tha se ata kishin vepruar në kundërshtim me statusin e tyre diplomatik, duke i shpallur “persona të padëshiruar”. Austria nuk dha detaje për aktivitetin e diplomatëve rusë, ndërkaq Ministria e Jashtme e Rusisë tha se ky vendim ishte i pabazë, duke paralajmëruar Vjenën për pasojë.

## Kim nget tankun e ri, bën thirrje për përgatitje për luftë

**PHENIANI, 14 MARS** - Lideri i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, iu bashkua trupave të tij në ushtrimin e përdorimit të tankeve luftarake të llojit të ri, nga ku bëri thirrje për përpjekje më të mëdha për t’u përgatitur për luftë, raportuan mediet shtetërore të enjten.

Stërvitja me tanke e Veriut u cilësua si përgjigje ndaj stërvitjeve të përbashkëta ushtarake vjetore të Shteteve të Bashkuara dhe Koresë së Jugut, të cilat pritet të përfundojnë të enjten pasditë.

Koreja e Veriut i sheh stërvitjet e rivalëve si përgatitje për pushtim.

Stërvitja e Veriut të mërkurën kishte për qëllim vlerësimin e aftësive luftarake të tankistëve dhe në të u përfshi një lloji i ri i tankut të luftës, të cilin Kimi e quajti “tanku më i fuqishëm në botë”, sipas agjencisë koreane të lajmeve, KCNA.

Gjatë stërvitjes tanket e rënda manovruan në rrethana të ndryshme të vështira luftarake dhe shkrepën predha në drejtim të shënjestrave. Kimi hipi në njërën prej tankeve të tipit të ri dhe e ngau vetë, sipas KCNA-së.

Ministria e Mbrojtjes e Koresë së Veriut u zotua se do të kryente “aktivitete përgjegjëse ushtarake” si

përgjigje ndaj stërvitjeve të vazhdueshme ushtarake nga ShBA-ja dhe Koreja e Jugut në Seul. Kimi më vonë i vëzhgoi ushtrimet e qitjes me artileri.

Stërvitja e përbashkët e ShBA-së me Korenë e Jugut përfshiu ushtrimin e postit komandues të stimuluar me kompjuter dhe 48 lloje të tjera të ushtrimeve fushore, dyfish më shumë se ushtrimet e mbajtura vitin e kaluar.

Koreja e Veriut e ka shtuar testimin e armëve prej fillimit të vitit 2022, në përpjekje për ta modernizuar dhe rritur arsenalin e vet bërthamor dhe raketor.



## Raporti vjetor i NATO-s: Prania e aleancës në Kosovë, kyçe për Ballkanin

**PRISHTINË, 14 MARS** - Prania ushtarake e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Kosovë është e domosdoshme për ruajtjen e paqes dhe stabilitetin në tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor, thuhet në raportin vjetor të NATO-s, të cilin do ta paraqesë të enjten në Bruksel sekretari i përgjithshëm i aleancës, Jens Stoltenberg.

Në raport theksohet se për vite të tëra misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, e ka ruajtur një ambient të sigurt dhe lëvizimor e lirë për të gjitha komunitetet në Kosovë, në bashkëpunim me organizatat e tjera ndërkombëtare si, Bashkimin Evropian, Kombet e Bashkuara dhe të tjerat. "Në vitin 2023 KFOR-i luajti rol kyç për të siguruar stabilitet në Kosovë pas rritjes së tensioneve në veri të Kosovës. Pas shpërthimit të dhunës në muajin maj dhe shtator, aleatët dislokuan rreth 1 000 forca rezervë për misionin, që paraqet rritjen më të madhe në një deçenieje. Kjo ia ka mundësuar KFOR-it ta trefishojë numrin e patrullimeve dhe ta katërfishojë praninë në veri të Kosovës", thuhet në raport.

Tensionet në veri të Kosovës filluan të rriten në fund të majit 2023, pasi kryetarët e rinj të komunave Zvečan, Zubin Potok dhe Leposaviq, të shoqëruar nga Policia e Kosovës, hynë në ndërtesat komunale.

Banorët serbë e kundërshtuan këtë dhe organizuan protesta që

kulmuan në dhunë më 29 maj në Zvečan, ku u plagosën dhjetëra demonstrues dhe ushtarë të KFOR-it.

Ato u përshkallëzuan disa muaj më vonë, më 24 shtator, kur Policia e Kosovës u sulmua nga një grup serbësh të armatosur në Banjaskë të Zveçanit në veri të vendit, ku mbeti i vrarë një polic dhe tre sulmues.

Si rrjedhojë, NATO-ja e shtoi numrin e ushtarëve të saj në misionin paqeruajtës, KFOR, në Kosovë. Sipas raportit të së enjtes, tani misioni i KFOR-it i ka 4 700 pjesëtarë në Kosovë, përfshirë edhe forcën rezervë.

Në raportin e tij vjetor, Stoltenbergu përmend edhe ndihmën që NATO-ja ua ka ofruar organizatave të sigurisë në Kosovë për ndërtimin e kapaciteteve të tyre, sidomos në fushën e logjistikës, për mbështetje mjekësore, prokurim dhe menaxhim të resurseve njerëzore.

Edhe në këtë raport shprehet mbështetje e NATO-s për dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

"NATO-ja mbetet e përkushtuar për mbështetje të dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Dialogu është platforma kryesore për arritjen e zgjidhjes e cila respekton të drejtat e të gjitha komuniteteve dhe ndërtimin e paqes së qëndrueshme, që është në dobi



të sigurisë së Kosovës dhe stabilitetit të tërë rajonit të Ballkanit Perëndimor", thuhet në raport.

Në këtë raport të hollësishtëm përmenden aktivitetet kryesore të NATO-s në vitin e fundit, nga angazhimi për ndihmë Ukrainës për t'u përballur me agresionin e

Rusisë, rritja e pranisë në krahun lindor për ta siguruar mbrojtjen e territorit të të gjitha vendeve anëtare, rritja e investimeve për forcimin e kapaciteteve ushtarake të aleancës, deri tek angazhimi në misionet, siç është ai i KFOR-it në Kosovë.

NATO-ja paraqet rregullisht

raport vjetor për aktivitetet e veta. Raporti i paraqitur të enjten në Bruksel konsiderohet i fundit i paraqitur nga sekretari i tanishëm Stoltenberg, pasi pritet që së shpejti, mundësisht para samitit në Uashington në korrik, aleatët të pajtohen për emërimin e pasardhësit të Stoltenbergut.

## Ballkani goditet nga një tërmet i fuqishëm, lëkundjet ndihen edhe në Kosovë



**PRISHTINË, 14 MARS** - Një tërmet i fortë 5.4 ballësh i ka goditur disa vende të Ballkanit Perëndimor të enjten herët në mëngjes.

Epiqendra e tij ishte në Mal të Zi. Lëkundja nga tërmeti është ndier në Kosovë, Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci dhe Shqipëri.

Qendra Evropiane Sizmologjike Mesdhetare (EMCS) njoftoi se epiqendra e tërmetit që u regjistrua në orën 4:06 të mëngjesit ishte në një thellësi prej dhjetë kilometrash në qytetin perëndimor të Malit të Zi, Nikshiq.

Departamenti i Sizmologjisë i Institutit për Hidrometeorologji dhe Sizmologji të Malit të Zi bëri

me dije se ka regjistruar një tërmet 5.4 ballësh. "Ky tërmet mund të ketë shkaktuar dëme materiale në zonën e epiqendrës së tij", njoftoi Institutit.

Lëkundjen intensive e kanë ndier edhe qytetarët e Bosnjë-Hercegovinës, ndërsa sipas komenteve në faqen e internetit EMCS, tërmeti është ndier edhe në Kroaci.

Në orën 4:30 të mëngjesit të së enjtes, Mali i Zi është goditur nga një tjetër tërmet, por me magnitudë më të dobët - 3.1 ballësh, raportoje EMCS.

Pas tërmetit të parë të fortë të së enjtes në mëngjes, pasoi një seri prej rreth 30 lëkundjesh më të

dobëta, u tha gazetarëve të enjten shefja e Departamentit të Sizmologjisë malazeze të Institutit Hidrometeorologjik, Milena Tomanović. Ajo njoftoi se aktualisht nuk ka raportime nga terreni nëse ka dëme të mëdha materiale.

Gati saktësisht 45 vjet më parë, më 15 prill 1979, Mali i Zi ishte goditur nga një tërmet me magnitudë 7 ballësh.

Epiqendra e tij ka qenë në Detin Adriatik, në mes të Ulqinit dhe Tivarit, rreth 15 kilometra nga bregdeti. Në atë kohë humbën jetën 101 persona në Mal të Zi dhe 35 në Shqipëri, ndërsa mbi 100 mijë persona mbetën të pastrehë.

## Kontingjenti i FSK-së përfundon trajnimin para dislokimit në Belize

**PRISHTINË, 14 MARS** - Në kuadër të bashkëpunimit bilateral me Mbretërinë e Bashkuar, Forca e Sigurisë së Kosovës, me një kontingjent, do të marrë pjesë në stërvitjen e përbashkët ushtarake që

do të realizohet në Belize. Kontingjenti i FSK-së ka përfunduar trajnimin para dislokimit me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë realizuar në bazën ushtarake-detare në Kepin e Palit me qëllim të

përgatitjes në aspektin operacional dhe taktik për ta përfaqësuar vendin tonë dhe për t'i treguar aftësitë profesionale dhe ndërvepruese me partnerët pjesëmarrës në ushtrim.





## Opozita komenton vendimin e qeverisë për tokën e Manastirit të Deçanit: Kurti me kauza të rrejshme erdhi në pushtet

Tri partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), kanë komentuar të enjten vendimin e qeverisë Kurti për dhënien e 24 hektarëve tokë Manastirit të Deçanit. Liderët e partive opozitare, Memli Krasniqi, Lumir Abdixhiku dhe Ramush Haradinaj, kanë theksuar se Kurti me kauza të rrejshme erdhi në pushtet. Sipas tyre, ka qenë vetë kryeministri Kurti që dikur e ka kualifikuar tradhtit një vendim të tillë, duke anatenuar e sulmuar secilin protagonist politik të vendit tonë ndër vite, e sot vetë po i zbaton këto vendime



Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 14 MARS** - Tri partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e kanë komentuar të enjten vendimin e qeverisë Kurti, e cila i ka kërkuar Agjencisë Kadastrale të Kosovës ta zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të vitit 2016 për tokën e Manastirit të Deçanit.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, e ka quajtur të papërgjegjshëm kryeministrin Kurti, për të cilin thotë se nuk ka zgjedhur gjuhë e as veprime për të ardhur në pushtet dhe se ai e ka kualifikuar si tradhtit vendimin

e Kushtetueses që tashmë kërkon të zbatohet për Manastirin e Deçanit.

Krasniqi ka thënë se Kurti e ka ditur që ky vendim është obligues por, pavarësisht prej kësaj, e ka përdorur si çështje për interesin personal dhe partiak. "Ky është çmimi që paguan shoqëria për një politikan të papërgjegjshëm, i cili nuk ka zgjedhur as gjuhë dhe as veprime për të ardhur në pushtet e po detyrohet të shkelë mbi secilën fjalë përmes së cilës ka ardhur deri këtu. Kryeministri Kurti e ka ditur që nga fillimi se ky vendim është obligues, por e ka përdorur këtë çështje, siç ka përdorur shumë të tjera, për ta përçarë opinionin me gjuhë helmuese, duke pasur parasysh vetëm interesin personal dhe partiak dhe jo atë qytetar dhe

shtetëror", ka deklaruar Krasniqi për "Express".

Ai ka thënë se nga moszbatimi i këtij vendimi, Kosova ka pësuar ndalje në ekonomi, raporte të tensionuara me ndërkombëtarët etj. "Ju kujtohet, ka qenë vetë kryeministri që dikur e ka kualifikuar si tradhtit një vendim të tillë, duke anatenuar e sulmuar secilin protagonist politik të vendit tonë ndër vite. Sot është vetë ai që po i zbaton këto vendime. Tani çështja kryesore është se çfarë ka humbur Kosova: vite të shumta të humbura në agjendën e saj integruese, sanksione e masa ndëshkuese nga aleatët kryesorë e që nënkupton edhe stagnim të progresit ekonomik, tensionim të raporteve me partnerët ndërkombëtarë, si dhe humbje të respektit për shtetin tonë, mes shumë dëmeve të tjera", tha kreu i PDK-së, Memli Krasniqi.

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të pakontestuar dhe janë të zbatueshme. Ai ka thënë se kryeministri Kurti ka zgjedhur me vetëdije të plotë që në kauza të tilla të rrejshme ta ndërtojë bazën për ardhjen në pushtet por, sipas tij, pas ardhjes në pushtet ka kuptuar se kauzat e rrejshme nuk qëndrojnë. "Tani vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të pakontestuar dhe kur them të pakontestueshme, nënkupton që edhe ato janë edhe

të zbatueshme. Është shenjë e pjekurisë demokratike, fillimisht për një shtet dhe shoqëri, dhe ky ka qenë qëndrimi ynë i gjithëhershëm si LDK. Fatkeqësisht, Kurti ka zgjedhur me vetëdije të plotë që në kauza të tilla të rrejshme ta ndërtojë bazën për ardhjen në pushtet dhe tani në pushtet ka kuptuar se kauzat e rrejshme nuk qëndrojnë, por gjithsesi ato janë të dëmshme. Pra ka ardhur në pushte me kauza të rrejshme, e kjo është pasojë e madhe për vendin, për stabilitetin politik dhe demokratik", ka thënë ai.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, këtë vendim të Kurtit për Manastirin e ka quajtur "fik e korit", ndërsa ka theksuar se shefi i ekzekutivit po i bën shumë dëme Kosovë. "Ajo shprehja e popullit edhe fik edhe korit, po na ndodh me Kurtin në mënyra se si ky po i trajton aleatët dhe obligimet që i ka marrë me aleatët do t'i kushtojnë Kosovës. Do ta kem një presion të vazhdueshëm për shumë tema të tjera. E rrugës do të ishte pas kësaj që ka ndodhur dje, Kurti të rikthehet në planin franko-gjerman për shkak se ju shihni Këshillin e Evropës, anëtarësimin në Këshillin e Evropës", është shprehur Haradinaj.

Vendimi i Qeverisë së Kosovës për Manastirin është përshëndetur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga ambasadori gjerman në

Prishtinë, Jorn Rohde, ambasadori i BE-së, Tomasz Szunyog, dhe nga kreu i misionit në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Michael Davenport.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të mërkurën se qeveria e tij i ka kërkuar Agjencisë Kadastrale të Kosovës ta zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të vitit 2016 për tokën e Manastirit të Deçanit.

Kurti edhe sa ishte opozitë dhe tash së fundmi në pushtet, në deklarimet e tij në medie e kishte kundërshtuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese që t'ia lejojë Manastirit të Deçanit t'i regjistrojë 24 hektarë tokë dhe pyll, duke pretenduar se kjo pronë nuk i takon manastirit.

Në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, në paraditen e 13 marsit, kryeministri ka thënë se kjo është bërë për shkak se zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese, që kërkon transferimin e 24 hektarëve tokë të Manastirit të Deçanit, do të ishte vendimtar për aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës gjatë Asamblesë Parlamentare të këtij institucioni që do të mbahet në prill.

Kurti ka thënë se ndonëse Qeverisë së Kosovës nuk i pëlqen vendimi, të cilin e ka cilësuar "të çuditshëm" dhe "të padrejtë", ajo nuk ka mjete ligjore dhe juridike për ta anuluar vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

## Escobari shkon në Pejë dhe Deçan

Pejë, 14 mars - I dërguari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, gjatë qëndrimit të tij në Kosovë, është ndalur në Pejë. Atë e ka pritur kryetari i kësaj komune, Gazmend Muhaxheri. "Isha i nderuar, që bashkë me ekipin tim, të isha nikoqir i takimit të z. Gabriel Escobar, i cili ishte i shoqëruar nga ambasadori i ShBA-së në Republikën e

Kosovës, shkëlqesisë së tij z. Jeffrey M. Hovenier me bashkëpunëtorë. Gjatë takimit, me theks të veçantë nga të dyja palët, është vlerësuar jetik rrugëtimi i përbashkët në proceset integruese të Kosovës bashkë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka shkruar Muhaxheri në "Facebook". Escobari në Pejë ka takuar pjesëtarë të shoqërisë civile,

gazetarë dhe të rinj nga komuniteti shqiptar, serb dhe boshnjak. Një ditë pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për Manastirin e Deçanit, emisari amerikan Gabriel Escobar ka vizituar edhe Manastirin e Deçanit. Escobari ka deklaruar një ditë më parë se vendimi për Manastirin është i vështirë, por duhet të ndodhë.



## Pushteti e lëshon seancën e Kuvendit për kontratat njëburimore, opozita e akuzon për korrupsion

EPOKA  
ERE

MaJ QORRAJ

PRISHTINË, 14 MARS - Grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e ka lëshuar të enjten seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit të thirrur nga Lidhja Demokratike e Kosovës "për numrin e madh të kontratave njëburimore të nënshkuara gjatë mandatit të qeverisë Kurti".

Shefja e grupit parlamentar i LV-së, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se nuk ka kuptim që të vazhdohet derisa vetë deputetja që e ka nënshkruar ftesën për thirrjen e seancës, Hykmete Bajrami, "na shajti me 'hajna, shpifësa e të korruptuar'".

E deputetët e opozitës, pa praninë e pushtetit, e kanë vazhduar seancën.

Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, si nismëtare e seancës, ka thënë se këto kontrata janë burim i korrupsionit. Ajo shtoi se, sipas komisionit rregullativ të prokurimit, gjatë këtij mandati qeverisë janë nënshkruar mbi 1 800 kontrata njëburimore në vlerë mbi 240 milionë euro. "Hajnat të zënë ngushtë shpifin në Kuvend. Unë kam qenë ministre në tri ministri, por asnjëherë nuk kam nënshkruar kontratë njëburimore. Asnjëherë. Sipas Ligjit të Prokurimit Publik, ministri nënshkruan kontratat në vlerë mbi 250 mijë euro", ka thënë ajo.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se sa është i domosdoshëm themelimi i



Komisionit Hetimor Parlamentar për kontratat njëburimore, të cilat janë burim i korrupsionit, mjafton të shohim se vetëm në dy vitet e fundit (2022 dhe 2023), në gjashtë ministri dhe në KEK janë nënshkruar 220 kontrata në vlerë prej 153,883,875.90 eurosh. "Pra vetëm në shtatë institucione mbi 150 milionë euro keqpërdorime, pa i përfshirë këtu kontratat e vitit 2021 e as kontratat milionëshe sekrete. Kontratat njëburimore janë bërë standard dhe rregull i përditshëm i kësaj qeverie dhe ministrive të saj.

Pra, është bërë rregull dhënia e kontratave në tavolina kafeneshe, pa procedura, pa konkurrencë dhe pa transparencë. Prandaj vetëm hetimi parlamentar mund t'i sqarojë përmasat e këtij abuzimi", ka thënë Tahiri.

Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka theksuar se kontratat njëburimore, edhe pse janë të lejuara me Ligjin për Prokurimin Publik, në secilin vlerësim vendor dhe ndërkombëtar, të Zyrës së Auditorit Kombëtar, të instancave që e

përcjellin menaxhimin publik të BE-së, tregojnë se janë mjeti më i mirë, potencialisht për dëmtimin e konkurrencës së lirë, për korrupsion dhe për favorizim nga sektori publik për sektorin privat. "Pra, po flasim për kontrata njëburimore, duke përfshirë anekse në vlerë 209 milionë euro, një shumë e madhe e parave të taksapaguesve të cilat kanë shkuar në kontraktim njëburimor. Kontraktimi njëburimor me një operator arsyetohet në rast se rrezikohet siguria kombëtare, por

nuk ka logjikë dhe as shpjegim për 781 kontrata që përfshin edhe aneks-kontratave në kontraktim njëburimor", ka thënë Tahiri.

Ai ka theksuar se në Ministrinë e Arsimit numri i kontratave është 41 në vlerë prej 10.2 milionë eurosh. "Kontrata njëburimore janë 29 sosh me vlerë 9.6 milionë euro. Ne po kërkojmë që këta ministra të raportojnë se mbi çfarë baze, arsyeshmërie i kanë nënshkruar këto kontrata njëburimore, për shkak se dyshimi është i bazuar se mund të ketë subjekt të korrupsionit. Edhe te Ministria e Drejtësisë është e njëjta situatë. Po ashtu edhe te të tjerat. Kulminacioni i kësaj teme është te KEK-u. Tenderët njëburimorë në vitin 2022 kanë shënuar rritje të madhe. Kampion i tenderëve njëburimorë është KEK-u. Problemi është se aty ka dalë dyshimi për korrupsion. Aty është duke ndodhur hetimi. Para se ta kualifikojmë a është korrupsion, na duhet ta trajtojmë këtë temë seriozisht", ka deklaruar deputeti Besnik Tahiri.

Pas këtij debati nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, Kujtim Shala, ka bërë me dije se nuk ka kuorum të procedohet me votimin e propozim-rezolutës për numrin e madh të kontratave njëburimore të nënshkuara gjatë mandatit të qeverisë Kurti. "Meqë s'kemi kuorum që të procedojmë votimin e propozim-rezolutës, unë do ta ndërpres seancën. Për datën e vazhimit vendos Kryesia e Kuvendit", ka thënë Shala.

## Me protestë kërkohet siguri për vajzat dhe gratë

PRISHTINË, 14 MARS - Dhjetëra qytetarë kanë protestuar të enjten në Prishtinë, duke kërkuar siguri dhe drejtësi për vajzat dhe gratë, pas dyshimeve se një vajzë e mitur është dhunuar ditë më parë në Drenas.

Protestuesit kanë marshuar në sheshin "Zahir Pajaziti" në kryeqytet duke mbajtur në duar pankarta me mbishkrimin "Siguri për gratë", "Poshtë patriarkati!", "Gra, revoltuhuni" dhe "Drejtësi për gratë".

Protesta është organizuar nga Kolektivi për Mendim dhe

Veprim Feminist. Gjykata Themelore në Pejë pati konfirmuar se dy persona janë ndalur dhe ndaj tyre është caktuar masa e paraburgimit njëmuor, të dyshuar për dhunimin e një 13-vjeçarje në Drenas.

Policia e Kosovës në raportin e 11 marsit pati njoftuar se ishte duke e hetuar një rast të cilit cilësoi si "zhdukje e një viktime femër kosovare". "Raportohet se viktima femër kosovare, kishte dalë nga shtëpia dhe se nuk dihet për lokacionin e saj. Me datë 11.03.2024 rreth orës 00:50

njësitet e hetuesia ka lokalizuar viktimën e cila ishte e shoqëruar nga dy të dyshuarit meshkuj kosovarë. Rasti është duke u hetuar", thuhej në raport.

Rrjeti i Grave të Kosovës (RRGK) u bëri thirrje autoritetëve në "Facebook" t'i sjellin para drejtësisë të dyshuarit.

Në Kosovë, sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, çdo vit raportohen dhjetëra raste të dhunës seksuale.

Rrjeti i Grave të Kosovës ka thënë se numri më i madh i viktimave të kësaj dhune janë



vajzat e moshës 13 deri në 16 vjeç. Kodi Penal i Kosovës parasheh

dënime nga dy deri në 15 vjet burgim për dhunime dhe sulme të tjera seksuale.

## LDK-ja humbet shumicën në Kuvendin Komunal të Prishtinës, Fehmi Kupina zgjedhet kryesues

PRISHTINË, 14 MARS - Fehmi Kupina, ish-asamblisti i LDK-së, tani i pavarur, është zgjedhur kryesues i Kuvendit Komunal të Prishtinës me 22

vota për ( shumica të Vetëvendosjes). Tetë asamblistë të pranishëm kanë abstenuar, ndërsa ata të LDK-së e kanë bojkotuar seancën e

jashtëzakonshme. Kupina u zgjodh pas tre raundeve votimi në seancën e jashtëzakonshme që u mbajt të enjten. Kupina udhëhoqi

Kuvendin Komunal kur mori mandatin Lidhja Demokratike e Kosovës, por ndërkohë u shkarkua dhe doli asamblisti i pavarur.



## Hapet konkursi për krijimin e sheshit monumental "Adem Jashari" në Prishtinë



Prishtinë, 14 mars - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se është hapur konkursi për krijimin e sheshit monumental të komandantit legjendar Adem Jashari në kryeqytet. "Komandant Prishtina të pret! Kemi hapur

konkursin për krijimin e sheshit monumental të komandantit legjendar, Adem Jashari, që do ta ketë pjesë thelbësore monumentin e qendresës, guximit dhe lavdisë së heroit të kombit dhe familjes Jashari, si një prej themeleve më të rëndësishme të lirisë së

vendit. Ky shesh do të shërbejë jo vetëm si një simbol i sakrificës së tyre të madhe, por edhe si një vend ku brezat e sotëm dhe të ardhshëm mund të mësojnë një prej kapitujve më të rëndësishëm në historinë e kombit tonë", ka shkruar Rama në "Facebook".



## Policia gjëbëjëse dhe trafikantëve me xhama të errësuar

Prizren, 14 mars - Njësi Rajonal i Komunikacionit Rrugor dhe stacionet policore të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prizren, në kuadër të zbatimit të Ligjit për Rregullat në Trafikun Rrugor, kanë ndërmarrë një sërë aktivitete, duke shtuar kontrollin për identifikimin e kundërvajtësve në trafik, me theks të veçantë të atyre kundërvajtësve të cilët janë hasur duke drejtuar automjetet e tyre në të cilat kanë të vendosura folje ose ndonjë material tjetër

me qëllim të errësimit të xhamave në mjet. Në kuadër të këtij aktiviteti janë shqiptuar 42 gjoba për ngasësit e automjeteve të cilët kanë pasur xhamat e errësuar në automjetet e tyre. Drejtoria Rajonale e Policisë Prizren do t'i vazhdojë kontrollin në trafik, duke mbajtur pika të shumta të kontrollit të automjeteve me qëllim të zbatimit të ligjit në trafikun rrugor dhe parandalimit të aksidenteve në komunikacionin rrugor.

## Nis projekti për ndërtimin e Subqendrës në Qirez të Skenderajt

Skenderaj, 14 mars - Komuna e Skenderajt ka filluar zbatimin e projektit për ndërtimin e Subqendrës në fshatin Qirez, e cila do ta shndërron këtë fshat në një qendër moderne.

Kryetari i komunës, Fadil Nura, ka thënë se investimi më i madh në Qirez po bëhet realitet. "Është një projekt i rëndësishëm së veçantë për të transformuar edhe këtë lokalitet në një

qendër mirë të rregulluar me hapësira të modernizuara për afarizëm, bulevard të gjerë me infrastrukturë përcjellëse dhe qendrën rekreative", ka shkruar Nura në "Facebook".



## Përurohen investimet në shkollën "Skënderbeu" në Mitrovicë

Mitrovicë, 14 mars - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka vizituar Shkollën Filllore "Skënderbeu", në të cilën ka përfunduar investimet e bëra në këtë shkollë. Hamza

ka thënë se qeverisja lokale po vazhdon përbushjen e premtimeve për investime në arsim. "Me renovimin e Sallës së Sporteve gjatë vitit 2022, renovimin e tërësishëm të

pjesës së jashtme, ngrohjen dhe ndriçimin e objektit në bashkëpunim me FKKE, shkolla është shndërruar në një objekt modern dhe të veçantë për mbi 700 nxënës

dhe stafin e mrekullueshëm të kësaj shkolle", është shprehur kryetari Hamza. Ai ka shtuar se gjatë vitit 2024 do të investohet edhe në oborrin e kësaj shkolle.



## Vejevoda: Për dinarin duhet kompromis

Prishtinë, 14 mars - Ivan Vejevoda, nga Instituti për Shkencat Humane në Vjenë, thotë se për çështjen e përdorimit të dinarit serb në Kosovë, Prishtina dhe Beogradi duhet të gjejnë një zgjidhje kompromisi. Sipas tij, trysnia e bashkësisë ndërkombëtare mbi Kosovën është e justifikueshme marrë parasysh se vendimi për ta ndaluar dinarin serb ishte i

autoriteteve të Kosovës. Duke folur në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Vejevoda lë të kuptohet se Prishtina zyrtare duhet të konsultohet dhe t'i marrë parasysh këshillat e partnerëve ndërkombëtarë. "Qeveria e Kosovës mund të marrë çfarëdo vendimi që do, por ajo nuk jeton në vakum, jeton në juglindje të Evropës, me partnerë të cilët duan që ajo t'i

bashkohet BE-së dhe NATO-s", thotë Vejevoda. Sipas tij, vonesat në zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për tokën e Manastirit të Deçanit nuk i kanë ndihmuar imazhit të Kosovës. "Trysnia që është bërë mbi qeverinë e kryeministrit Kurti po jep tani rezultate, sepse të qenët kundër ka çuar, padyshim, në rrugë qorre", thotë ai.



## GLPS-ja: Projektligji për Zyrtarët Publikë, në kundërshtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese



Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 MARS - Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë është në kundërshtim me parimet moderne të administratës publike dhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, ka vlerësuar në një reagim për medie Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS).

GLPS ka njoftuar se ka analizuar me kujdes këtë proces dhe shpreh shqetësimin e thellë në lidhje me procedurën dhe përbajtjen e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë. "Sipas programit legjislativ të këtij viti, përgjegjësia për këtë iniciativë ligjore bie mbi Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), e cila, njëkohësisht, është përgjegjëse edhe për administratë publike", thuhet në këtë reagim.

GLPS-ja konsideron se i gjithë angazhimi dhe procedura e miratimit të këtij projektligji ka qenë totalisht jotransparente. "Ne mbesim të shqetësuar se si një proces i tillë është realizuar në heshtje të plotë, pa përfshirjen e palëve të treta dhe absolutisht në kundërshtim me rregullat dhe parimet për konsultime publike. Theksojmë se i njëjti projektligj nuk është publikuar fare në platformën për konsultime publike, dhe rrjedhimisht, palët e treta nuk kanë pasur fare informacion mbi



ndryshimet dhe plotësimet e propozuara nga ana e Qeverisë, apo MPB-së në këtë rast", theksohet në reagimin e GLPS-së, duke shtuar se sa i përket përbajtjes, projektligji, përveç që nuk ndjek urdhrin e përcaktuar në pikën 12 të aktgjykimit nr. ref.: AGJ 2262/23 të Gjykatës Kushtetuese të lëshuar më 12 shtator 2023, i njëjti zgjeron objektin e ndryshimit si dhe devijon këtë urdhër duke keqinterpretuar vetë frymën e këtij aktgjykimi.

Më tutje, GLPS-ja në përbajtjen e këtij projektligji vë theksin si dhe ndan shqetësimin sidomos në këto çështje: "Ky projektligj i propozuar së fundmi përjashton nga fusha e veprimtimit disa institucione

tipike të cilat duhet të jenë pjesë e fushëveprimit të LZP-së. GLPS konsideron se ky përjashtim është bërë në mënyrë të qëllimshme dhe në kundërshtim me parimet e SIGMA/OECD. E njëjta vlen edhe me dhënie të statusit të veçantë të disa kategorive në mënyrë të gabuar.

Zgjatja e afatit deri në dy vite për ushtruesit e detyrës është tendencë e qartë për ligjësimin e këtij fenomeni të rrezikshëm. Madje i njëjti ka parashikuar mekanizmin që brenda vetëm një muaji të përshtatet vendimet për ud-të aktual në mënyrë që vazhdohet kjo praktikë. Shqetësuese mbetet edhe heqja e pragut minimal që së paku dy kandidatë duhet t'i plotësojnë kushtet për nivelin e lartë drejtues, gjë që rezulton

me cenim të konkurrencës, si shtylla kryesore e meritokracisë. Tek lista pritëse, vendosja e marrëveshjes për praninë të nëpunësve civilë (sipas paragrafit 3 të nenit 67) nga institucioni që supozohet t'i pranojë nëpunësit civilë tepërisht në mënyrë diskrecionale, pa ndonjë detyrim ligjor, është shumë e rrezikshme dhe me qëllim mund të shpie në situata që institucionet mos t'i pranojnë nëpunësit tepërisht dhe të njëjtit në mënyrë masive të largohen nga shërbimi civil për shkak të kalimit të afatit 9 mujor të përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 67 të po këtij projektligji", theksohet në reagimin e GLPS-së.

Më tutje thuhet se kthimi i mandateve për nëpunësit civilë

aktualë, sipas paragrafit 3 të nenit 17 të projektligjit për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, është në kundërshtim të plotë me pikën IX të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese. "Pra, ky projektligj kufizon mandatin e shërbyesve civil të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese për nëpunësit aktual, gjë që është në kundërshtim të plotë me aktgjykimin e lartpërmendur. Duke marrë parasysh defektet e mëdha që ka ky projektligj, por edhe LZP-ja aktuale, GLPS-ja i bën thirrje Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës që të fillojnë një proces të ri të hartimit të politikave të shërbimit publik në përputhje me parimet moderne për administratë publike. Ndër të tjera, ne kërkojmë që në raste të tilla Qeveria të tregojë kujdes të shtuar në sigurimin e një qasje gjithëpërfshirëse, të bazuar në prova dhe analizë të mirëfilltë të të gjitha opsioneve më të mira dhe të përshtatshme, që ndër të tjera, garantojnë profesionalizëm, meritokraci dhe stabilitet të shërbimit publik. I rikujtojmë Qeverisë dhe institucioneve përkatëse që asja e deritanishme përveç që nuk i shërben procesit Integrues, është e dëmshme edhe për vetë shërbimin civil duke dekurajuar kuadrot e reja të jenë pjesë e tij në të ardhmen. Madje, të njëjtat i konsiderojmë si zgjidhje afatshkurtra dhe që i shërbejnë vetëm politikave ditore, duke mos siguruar qëndrueshmëri", është theksuar, ndër të tjera, në reagimin e GLPS-së.

## IKShPK-ja bën thirrje për vaksinim kundër HPV-së

Prishtinë, 14 mars - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka bërë thirrje për vaksinim kundër HPV-së për ta parandaluar kancerin e qafës së mitrës dhe sëmundjeve të tjera. "Një bashkëbisedim shumë i rëndësishëm me prindër dhe mësimdhënës në shkollën fillore 'Ismail Qemali' në

Mitrovicë, me qëllim të ndarjes dhe zgjerimit të informacioneve e njohurive të prindërve në lidhje me vaksinën kundër Human Papilloma Virusit. Vaksina HPV ka filluar të aplikohet në Kosovë për vajzat e klasave të gjashta. Gjatë këtij diskutimi të hapur, përfaqësues nga IKShPK, Zyra e OBSH-së në

Kosovë dhe profesionistë shëndetësor nga komuna e Mitrovicës, shpjeguan para prindërve rreziqet nga infeksioni me Virusin Human Papillom dhe përfitimet e drejtpërdrejta nga vaksina HPV në parandalimin e kancerit të qafës së mitrës dhe sëmundjeve të tjera. Me prindërit janë ndarë

informacione të rëndësishme me qëllim për t'i ndihmuar ata ta kuptojnë pse vaksinimi është një hap i rëndësishëm për të mbrojtur shëndetin e fëmijëve të tyre. Vaksinohuni kundër HPV-së për të parandaluar kancerin e qafës së mitrës dhe sëmundjeve të tjera serioze", ka njoftuar IKShPK-ja.



## Ismaili: Rregullorja e BQK-së s'krijon probleme, por shpërfaq veprimet e kundërligjshme

**PRISHTINË, 14 MARS** - Rregullorja e Bankës Qendrore të Kosovës, e cila përcakton që vetëm euroja të jetë valuta për pagesa me para të gatshme, duke i dhënë fund përdorimit të dinarit serb, nuk ka krijuar probleme, por ka shpërfaqur një fenomen të kundërligjshëm në Kosovë. Kështu tha guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili, gjatë raportimit për çështjen e dinarit serb para Komisionit Parlamentar për Buxhet, Punë Dhe Transfere.

BQK-ja nisi zbatimin e rregullores për operacione me para të gatshme më 1 shkurt pavarësisht prej thirrjeve nga faktori ndërkombëtar që Kosova ta shtyjë zbatimin e saj. "Rregullorja ka rritur integritetin e sistemit financiar, e ka bërë sistemin financiar më të sigurt dhe ka pamundësuar aktivitetet negative", tha ai.

Ismaili u shpreh se rregullorja e BQK-së nuk e kufizon pranimin e fondeve nga jashtë, por nuk lejon operimin në mënyrë të kundërligjshme, duke theksuar se nuk lejohet importi i parave nga

operatorët e palicencuar.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë kritikuar rregulloren e BQK-së, duke argumentuar se vendimi për të është marrë pa konsultime paraprake dhe pa marrë për bazë efektet negative ndaj popullatës serbe në Kosovë. Uashingtoni vazhdimisht ka kërkuar që Kosova ta shtyjë zbatimin e rregullores.

Më 12 mars, i dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, e ka quajtur "katastrofik" dhe "jokompetent" vendimin e autoriteteve të Kosovës për ta zbatuar këtë rregullore. "Ju siguroj edhe njëherë se asnjë partner ndërkombëtar, as Fondi Monetar Ndërkombëtar, as Banka Botërore, as ambasadorët në mënyrë individuale nuk kanë kërkuar prej nesh që ta shfuqizojmë rregulloren. Kërkesa e vetme që është bërë te ne ka qenë gjetja e një periudhe të përkohshme në mënyrë që të përshtatet një kategori e caktuar e qytetarëve të prekur nga kjo rregullore", tha Ismaili para deputetëve.



Megjithatë, Ismaili tregoi efektet që, sipas tij, ka sjellë zbatimi i rregullores. Ai tha se deri më tani janë licencuar pesë banka për transportin e parave të gatshme, që të kryejnë këtë punë me leje të veçantë nga BQK-ja. "Janë realizuar 20 transporte të monedhave, prej të cilave 19 janë eksport dhe një import. Po ashtu, ka një numër të llogarive të hapura në komunat në veri të Kosovës dhe nuk ka ndonjë pengesë në funksionimin e saj

[rregullores]", theksoi ai.

Ismaili nga deputetët e opozitës u pyet për pjesëmarrjen e tij, siç u tha, pa asnjë autorizim ligjor në dialogun në Bruksel, ku është diskutuar rregullorja që përcakton përdorimin e valutave të huaja në Kosovë.

Më 27 shkurt në Bruksel, delegacionet nga Kosova dhe Serbia, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, kanë diskutuar për çështjen e

përdorimit të dinarit. Delegacionin e Kosovës e udhëhoqi guvernatori Ismaili. "Nuk ka pasur negociata. BQK-ja nuk është organ që mund të negociojë, as nuk ka mandat të negociojë. Ne kemi informuar se çfarë përmban rregullorja dhe cilat janë mundësitë për zbatimin e rregullores", tha ai.

Serbia, që nga paslufta më 1999, e ka përdorur monedhën e saj për t'i paguar pensionet, ndihmat sociale dhe pagat për punonjësit e institucioneve paralele që ka në Kosovë. Në shumicën e dyqaneve në komunat e banuara më shumicë serbe edhe çmimet kanë qenë të ekspozuara në dinarë.

Serbia deklaroi se ndan miliona euro për serbët në Kosovë dhe ua paguan atyre rrogat, pensionet dhe ndihmën shtesë.

Në mungesë të dinarëve në vendbanimet e tyre në Kosovë, serbët e Kosovës më 12 mars udhëtuan dhjetëra kilometra drejt qyteteve serbe në afërsi të kufirit me Kosovën për t'i tërhequr mjetet që ata pranojnë nga Qeveria e Serbisë.

## "Termokos"-i do ta fillojë shpërndarjen e faturave testuese sipas konsumit

**PRISHTINË, 14 MARS** - Ndërmarrja Publike "Termokos" ka njoftuar se për muajin mars do ta fillojë kalkulimin dhe shpërndarjen e faturave me matje sipas konsumit për 1000 konsumatorë. Sipas njoftimit, këta konsumatorë janë përzgjedhur rastësisht, sipas një mostre reprezentative në ato lagje, ku është i shtrirë rrjeti i ngrohjes, përkatësisht të një pjesë e konsumatorëve, ku tanimë janë instaluar pajisjet matëse. "Këta klientë do t'i marrin dy fatura në pliko, një faturë reale të faturimit sipas sipërfaqes ngrohëse dhe një draft faturë krahasuese sipas konsumit", thuhet në komunikatën për medie. "Termokos"-i më tej ka bërë me



dije se me dërgimin e këtyre faturave testuese fillon edhe fushata sensibilizuese e fokusuar

në promovimin e kursimit dhe ndryshimit të shprehjeve për shfrytëzimin e ngrohjes. "Faturat

e dizajnuara sipas konsumit, tashmë janë aprovuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji. "Termokos" është në proces të vazhdueshëm të testimit të softuerit dhe komponenteve tjera të projektit "Prishtina Heatsave". Deri më tani 17.500 banesa kanë përfituar nga pajisjet falas në banesat e tyre, përfshi termokokat moderne, që kontrollojnë nivelin e ngrohjes", thuhet në komunikatë.

Ndërmarrja ka aplikuar tek të gjithë konsumatorët, që në dy javët e ardhshme të kursejnë maksimalisht ngrohjen, në mënyrë që të analizohen dhe krahasohen nivelet e konsumit individual, por edhe kolektiv. "Këto 1.000 familje, që do të marrin faturën model do të kenë

mundësi t'i analizojnë shpenzimet e veta sipas faturës me metra katrorë dhe asaj sipas konsumit", thuhet në komunikatë.

Derisa të dhënat fillestare analitike dëshmojnë se shumica e konsumatorëve kanë filluar të kursejnë, "Termokos"-i ka bërë thirrje që nga sezoni ngrohës 2024/2025 kursimi të jetë shprehë e vazhdueshme. "Ngrohja në të ardhmen do të kalkulohet sikurse edhe rryma apo uji, me matje. Sa më shumë kursehet, aq më pak paguhet. Draft faturat testuese të konsumit, që do të shpërndahen me faturat e zakonshme të marsit kanë një shirit të kuq dhe nuk janë paraparë të paguhet", theksohet në komunikatën për medie.

## BQK-ja vlerëson mbështetjen e bankës italiane "Banca d'Italia"

**PRISHTINË, 14 MARS** - Zëvendësguvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Dardan Fusha, me ekipin e tij, priti në takim përfaqësuesit e Bankës së Italisë ("Banca d'Italia"), Gianluca Maddaloni dhe Roberto Zuccala, si pjesë e misionit për mbështetjen e BQK-së në fushën e operacioneve me para të gatshme, në kuadër të Programit për Fuqizimin e Kapaciteteve të Bankave Qendrore të vendeve të Ballkanit Perëndimor për Integrim në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore dhe Banka

Qendrore Evropiane (ECB) i financiar nga Bashkimi Evropian.

Qëllimi i kësaj vizite pune dyditore është në mbështetje të BQK-së për avancimin e infrastrukturës ligjore dhe teknike, si dhe praktikave për operacionet me para të gatshme, si vijim i misionit paraprak për këtë qëllim të realizuar në nëntor të vitit 2023, ku u shqyrtua korniza ligjore e BQK-së për çështjen e operacioneve me para të gatshme.

Zëvendësguvernatori Fusha gjatë këtij takimi i njoftoi përfaqësuesit e Bankës së

Italisë lidhur me aktualitetet në sistemin financiar të vendit, objektivat dhe planin strategjik të BQK-së, përfshirë planin për avancimin e luftimit të dukurisë së parave të falsifikuara dhe modernizimin e sistemit të pagesave dhe synimin për anëtarësimin në Zonën e Vetme të Pagesave Euro të BE-së (SEPA).

Me këtë rast, zëvendësguvernatori i BQK-së shprehu vlerësimet dhe konsideratat më të larta për mbështetjen e Italisë ndaj Kosovës, me theks të "Banca d'Italia" ndaj Bankës



Qendrore të Republikës së Kosovës, që përmes projekteve të ndryshme ka kontribuar në ngritjen e

kapaciteteve dhe avancimin e shumë proceseve dhe praktikave në kuadër të BQK-së.



# DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË



Prof. dr. Sabit SYLA & Prof. dr. Hamit KABA

-1-

## Kronologji e ngjarjeve në Kosovë, 11 mars -31 maj 1981

### Prishtinë, 11 mars

19.00- Demonstrata në Mensën e Studentëve të Universitetit. Zgjatën deri në 05.00, më 12 mars, në zonën midis konvikteve të studentëve. Gjatë demonstratave, u përdorën forcat e milicisë kundër demonstruesve. Asnjë student nuk u dëmtua rëndë, përveç dy milicëve, njëri nga një plumb pistolette dhe tjetri nga një gur në sy. 18 anëtarë të Forcave të Sigurisë u raportuan të dëmtuar lehtë.

### Prishtinë, 12 mars

Udhëheqësit e demonstratave u identifikuan nga Forcat e Sigurisë. 80 prej tyre ishin nga Kosova dhe 20 nga vende të tjera por të gjithë ishin studentë në Universitetin e Prishtinës.

Seancë e përbashkët e Komitetit të Përgjithshëm të LK-së së Kosovës dhe Kryesisë së Kosovës duke shtuar Kryesinë e LK-së së Kosovës. Deklaratë e nxjerrë nga "Tanjug".

### 16 mars

Zjarr misterioz në Patriarkanën e Pejës.

### Prizren, 25 mars

11.30. 30 studentë sulmuan dhe dëmtuan Kolegjin e Trajnimit të Mësuesve.

12.30. Trazirat shpërndahet nga Forcat e Sigurisë. U konstatua se rebelët përbëheshin nga nxënës të Shkollës së Mesme në Prizren dhe nga Kolegji për Trajnimin e Mësuesve, plus nxënës nga shkolla e mesme në Suhareka. Forcat e milicisë u guajtën me gurë: u dëmtua një milic.

### Podujevë, 26 mars

Grevë

### Prishtinë

07.00. Rreth 500 studentë u mblodhën në kampusin e Universitetit.

12.40. Rreth 300 studentë duke bërë turrë me parulla dolën nëpër rrugë.

14.00. Një grup i madh studentësh

u drejtuan qytetit me qëllim që të prishnin manifestimet në Stafetin e të Rinjve.

16.30. U përdorën njësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Prishtinës dhe njësi speciale kundër rebelimit nga Ministria e Federale e Punëve të Brendshme (të cilat kishin arritur në Prishtinë një ditë më parë) për të shpërndarë demonstratën. U konstatuan 32 studentë të plagosur (1 i plagosur rëndë); 12 anëtarë të Forcave të Sigurisë (1 i plagosur shumë rëndë). Pati dy të shtëna me armë revolver nga demonstruesit por nuk pati të plagosur.

17.30. Demonstrata u shpërnda; 200 demonstrues u arrestuan, 21 nga të cilët u ndaluan.

### 27 mars

U mbajt seancë e përbashkët e Komitetit Krahinor dhe Kryesisë së Kosovës ku u vendos që të përshejtohej vlerësimi i ngjarjeve.

### 28 mars

Kryesia e Lidhjes Socialiste të Prishtinës u mblodh për të shqyrtuar "disa probleme socialo-ekonomike".

### Obiliq, 30 mars

13.00. 200 studentë nga Shkolla e Mesme dolën në demonstratë. Demonstrata u shpërnda nga Forcat e Sigurisë; ka të dhëna se punëtorët e Termocentralit "Kosova B" janë nxatur që të bashkohen me demonstratën.

Prishtinë Studentët e fakulteteve të ekonomikut, drejtësisë dhe matematikës bojkotuan mësimin.

### Podujevë, 1 prill

11.00. 200 studentë dolën në demonstratë.

17.00. Rreth 10 demonstrues u plagosën, 3 prej tyre rëndë; 1 milic i plagosur lehtë.

### Prishtinë

13.00. Studentë nga Fakulteti Ekonomik Bujqësor i Shkollës së Mesme dolën në demonstratë.

15.00. Me demonstratën u bashkuan disa punëtorë ndërtimi dhe më vonë punëtorë nga Fabrika e Amortizatorëve-Prishtinë, nga koncerne të ndryshme ndërtimi në

Prishtinë dhe nga kompania aty afër në Obiliq. Demonstruesit thërrisnin parulla që përfshinin "Kosova për kosovarët", "Kosova Republikë" dhe "Rroftë Adem Demaçi" (shqiptar irredentist i cili aktualisht gjendej në burg në Jugosllavi). Demonstruesit numëroheshin rreth 3-4 000 veta nga të cilët autoritetet pretendonin se 2 700 ishin studentë.

21.00. Demonstrata më në fund u shtyp. 18 demonstrues të plagosur: 3 rëndë, 17 anëtarë të Forcave të Sigurisë: 2 rëndë. Nuk janë përdorur të shtëna armësh gjatë demonstratës.

"Tanjug" botoi një deklaratë të shkurtër për elementët nacionalistë armiqësorë që prishin rendin dhe për marrjen e masave përkatëse të sigurisë.

U mblodh Kryesia e Përbashkët e Kosovës me atë të LK-së së Kosovës për të vendosur për masat që duhen marrë.

### Prishtinë, 2 prill

06.00. Demonstratat filluan sërisht. Grupe punëtorësh nga 2 organizata në Prishtinë dhe 1 organizatë në Vushtri okupuan stacionin e autobusit dhe hodhën parulla. Demonstrata u shpërnda nga Forcat e Sigurisë. Tjetërkund në Prishtinë studentët bërësin me parulla nacionaliste të tilla, si: "Jemi fëmijët e Skënderbeut, ushtarë të Enver Hoxhës".

09.00. Grupe të vogla në pjesë të ndryshme të qytetit po formonin grupe të reja me studentë nga fakultete të tjera dhe punëtorë nga organizatat "Putë", "Voça" dhe "Crepo-Cigllana".

10.30. Formohen grupe të tjera në qytet dhe përreth tij dhe në fshatin e Devet Jugovicë. Demonstruesit, qytetarët dhe fshatarët bënë presion ndaj autoriteteve të Sigurisë. Një ngjarje e tillë e ngjashme ndodhi në një zonë afër Obiliqit.

14.00. Grupe demonstruesish, punëtorësh dhe fshatarësh bllokuan një njësi të vogël të mbrojtjes territoriale e cila mundi të arrinte në Prishtinë vetëm në orën 16.00. Në mesin e këtyre demonstruesve kishte njerëz të armatosur me armë zjarri.

15.00 - Grupe punëtorësh, disa të armatosur mbërritën në Prishtinë.

16.00 - Një grup i madh demonstruesish arriti në periferi të Prishtinës duke ecur drejt qendrës së qytetit.

20.00 - Demonstrata u shpërnda. Komiteti për Mbrojtjen e të Gjithë Popullit dhe Vetë-Mbrojtjen Sociale të Prishtinës nënshkroi një urdhër për të rrethuar qytetin me tanke. U vendos ndalimqarkullimi në Prishtinë, Podujevë, Lipjan, Vushtri dhe Glllogoc nga ora 20.00 deri në 05.00. Përforcime për Forcat e Sigurisë mbërritën në Prishtinë nga Republikat e tjera dhe nga Vojvodina. U ndalua grupimi i më shumë se 5 personave në vende

publike.

Podujevë Demonstratat filluan herët në mëngjes më shumë nga studentët, por në radhët e tyre kishte edhe qindra qytetarë, punëtorë dhe fshatarë. Ata u përpoqën të bllokonin rrugën për në Prishtinë për të penguar Forcat e Sigurisë që të hyjnë në Podujevë. Nga Podujeva erdhën përfundimisht njësi territoriale në ndihmë të tyre. 34 shtëpive të serbëve dhe malazezëve iu u zjarr. Vushtri 12 punëtorë nga organizata "Kosova", ishin së bashku me një turmë prej rreth 150 studentësh duke thirrur parulla.

### Lipjan

15.20 - Rreth 450 studentë që bërësin hynë me forcë në qytet dhe thyen xhamat e një pike karburanti dhe dyqaneve në përgjithësi. Demonstrata u shpërnda nga Forcat e Sigurisë rreth orës 17.00.

### Gjilani

18.00 - Një grup prej rreth 30 studentësh në qytet hidhnin parulla. Demonstrata u shpërnda nga Forcat e Sigurisë.

### Glllogoc

10.00 - Studentë nga Shkolla e Mesme filluan të dalin në demonstratë; më vonë u bashkuan disa qytetarë, duke përmbytur makina dhe duke i vënë zjarrin atyre. Disa demonstrues qëlluan me armë, dhe një student u plagos. Në varrezat e zonës disa nga demonstruesit shkullën gurët e varrit. Demonstruesit morën një armë automatik nga një prej Forcave të Sigurisë (që më vonë u mor sërisht).

### Gjakovë

18.00 - Një grup prej rreth 100 studentësh thërrisnin parulla; ata u shpërndanë nga Forcat e Sigurisë. Seancë e Përbashkët e Kryesisë Federale dhe Presidiumit të LKJ-së ku shqyrtuan situatën politike dhe të sigurisë në Kosovë.

Deklarata e Xhavit Nimanit për ngjarjet në Kosovë.

Seancë e Kryesisë së Përbashkët të Serbisë dhe LK-së së Serbisë.

### Ferizaj, 3 prill

09.00 - Një fabrikë druri u okupua prej rreth 200 punëtorësh.

13.00 - Ata u larguan nga fabrika dhe dolën në rrugë ku me ta u bashkua një grup studentësh. Më vonë filluan të hidhnin parulla të tilla si "Çmobilizoni njësitë e mbrojtjes territoriale në fabrika", "Nuk duam tanke në Krahinë", "Nxirmi shokët tanë nga burg", "Nuk duam që fëmijët tanë të rrihen nga policë jashtë Krahinës". Demonstruesit filluan më pas të thyejnë xhamat e dyqaneve dhe apartamenteve, të përmbysin makina, të shkatërojnë kioska dhe të dëmtojnë rëndë Hotel Ljubotan. Gjatë demonstratës u dëgjuan të shtëna armësh.

20.00 - Demonstrata dështoi për arsye të ndalimqarkullimit.

### Vitë

10.00 - Një grup prej 100 studentësh

demonstruan duke hedhur parulla. Forcat e Sigurisë e shpërndanë demonstratën me ndihmën e një pjesë të stafit mësimdhënës.

### Vushtri

10.00 - Një grup studentësh dhe disa punëtorë demonstruan në rrugë duke mbajtur foto të Titos me vete, por nën parullën "Republikë me hir a me pahir". Ata u përpoqën të hyjnë në shkollën e Punëve të Brendshme, por nuk u lejuan. Të afërmit e demonstruesve, të përkulur në dritaret e shtëpive, qëlluan me armë në drejtim të Forcave të Sigurisë dhe kështu forcat e milicisë duhej t'i përgjigjeshin edhe ata me zjarr. Demonstrata u qetësua para mbrëmjes.

### Mitrovica

11.00 - 80 punëtorë nga fabrika të ndryshme dolën në rrugë dhe me ta u bashkuan edhe studentët. Ata mbanin një fotografi të Titos në krye të kolonës. Me ta u bashkuan edhe studentët. Ata thyen xhamat në dyqane të ndryshme dhe thërrisnin parullat "Trepça punon për Serbinë" dhe "Rroftë Kosova Republikë". Demonstrata u shpërnda pa përdorur armë zjarri. Sipas statistikave zyrtare deri më 3 prill:

Nga demonstruesit: 8 të vdekur dhe 130 të plagosur, 55 me plagë nga armë zjarri.

Nga Forcat e Sigurisë: 1 milic i vdekur me armë zjarri, 135 të plagosur, 4 nga të cilët rëndë.

Dëmi material deri në këtë datë është vlerësuar të jetë rreth 9 milionë dinarë. Forcat e Sigurisë kanë arrestuar 956 njerëz: 219 të ndaluar dhe 45 të akuzuar.

### Fadil Hoxha: fjalim në Prishtinë

#### 4 prill

Dushan Dragosavac foli me redaktorë gazetash në Beograd. Dobrirovo Viđić foli në komunën Vračar në Beograd.

### Hapet central hidroelektrik në Kosovë.

#### 6 prill

Seancë e LK-së së Kosovës. Fjalim nga Dushan Ristić. Konferencë për shtyp në Beograd për gazetarët e huaj dhënë nga Stane Dolanc, i cili u shpreh për viktimat se kishte 11 të vdekur dhe 57 të plagosur.

#### 8 prill

Hiqet ndalimqarkullimi në Prishtinë dhe komuna të tjera. Kryeartikulli i gazetës "Zëri i Popullit" publikoi veprime sulmuese të jugosllavëve në Kosovë.

Gazeta "Rilindja" (Prishtinë) përgjigjet. Radio Zagrebi sulmoi gazetën "Zëri i Popullit".

#### 10 prill

Gazeta "Bashkimi" (Tiranë) sulmoi Jugosllavinë për regjistrimin e përgjithshëm në Kosovë.

11 prill Radio Zagrebi pretendonte se ndoshta Shqipëria kishte pretendime territoriale në Jugosllavi.

Mbledhja e konferencës së LK-së së Kosovës në qytetin e Prishtinës.

13 prill Shkollat fillore në Prishtinë rifillojnë mësimin.

Mbledhja e Lidhjes Socialiste të Kosovës: fjalim nga Azem Vllasi. Shifrat e viktimave flasin për 9 të vdekur, 257 të plagosur: 75 demonstrues të plagosur rëndë, 55 të plagosur lehtë; 127 anëtarë të Forcave të Sigurisë të plagosur.

15 prill Fjalim i Dushan Dragosavac para aktivitet politik në Obiliq.

16 prill Kolë Shiroka sulmon në gazetën "Bashkimi".

17 prill Bakalli tha në një konferencë për shtyp për gazetarët e huaj se 28 organizatorët të lëvizjeve ishin nën hetim. Shkollat e mesme dhe Universiteti i Prishtinës do të rihapen më 20 prill.

18 prill Fjalim i Fadil Hoxhës në Prishtinë.

Fjalim i Bahri Oruçit në Mitrovicë.

19 prill Gazeta "Pravda" sulmon komentet e Teslicë në gazetën "Borba" të datës 12 prill.

20 prill Fjalim i LK-së së Kosovës në Prishtinë.

Përfundon regjistrimi i përgjithshëm në Kosovë.

21 prill Fjalim i Xhavit Nimanit në Prishtinë me rastin e 40-vjetorit të kryengritjes në Kosovë.

22 prill Dr. Ivo Margan: fjalim para Kryesisë Federale.

23 prill Gazeta "Rilindja" sulmon një tjetër artikull të gazetës "Zëri i Popullit".

24 prill Mbledhje e Kryesisë së Kosovës.

Fjalim i Enver Rexhepit ku jep detaje për ngjarjet 11 mars-4 prill.

25 prill Një grup prej 20 të rinjsh dhe studentësh që mbajnë veshur kostume kombëtare shqiptare si një gjest "nacionalist" marshojnë nëpër Prishtinë.

27 prill Fjalim i Fadil Hoxhës në Prishtinë.

28 prill Mbledhje e përbashkët e Kryesisë së Republikës së Serbisë dhe LK-së së Serbisë. Fjalim nga Galovaç.

29 prill Fjalim i Lazer Kolishevskit në një mbledhje të përbashkët të Kryesisë Federale dhe Këshillit Federal për Mbrojtjen e Rendit Kushtetues.

Mbledhje e Kosova SUBNOR.

Mbledhje e Kryesisë së LKJ-së.

30 prill Broshura të shpërndara në Deçan ku bëhet thirrje për demonstrata të tjera.

Raport për një fabrikë në Vushtrri së cilës i është vënë zjarri nga nacionalistë shqiptarë (i pakonfirmuar).

Istog 8 njerëz të arrestuar për pjesëmarrje në demonstrata, të veshur me qeleshe të bardha shqiptare. Më vonë u liruan. Autoritetet e kuptuan më pas se kishin lënë të lirë udhëheqës të një grupi kundërrivolucionar (11 milicë dhe 2 demonstrues të plagosur).

2 maj Demonstrata të ndryshme të vogla në Podujevë, Lipjan, Grabovac dhe Pejë të shënuara nga qytetarët. Demonstrata në Ferizaj ku u thyen xhamat e një kishe.

4 maj Kryetari i RSFJ-së, Cvijetin Mijatović mbajti fjalim.

5 maj Fjalim nga Ali Shukrija në mbledhjen e LK-së së Kosovës. Bakalli jep dorëheqjen dhe Veli Deva zgjedhet në vend të tij.

13.45 250-300 studentë nga Shkolla e Mesme lanë ambientet e shkollës dhe u drejtuan në rrugë duke thirrur parulla.

Dobro Selo 11.00 30-40 studentë thyen xhamat e makinave dhe gjuajtën me gurë.

6 maj Mbledhje e LK të Serbisë; fjalim nga Tihomir Vlaskalić. Zjarr në një fabrikë tekstilësh në Prishtinë.

7 maj Mbledhje e KQ-së së LKJ-së: fjalim nga Llazar Mojsov.

8 maj Mbledhje e Kryesisë së RSFJ-së në të cilin u diskutuan marrëdhëniet me Shqipërinë.

9 maj Fjalim i Dragoslav Marković në Paraçin.

10 maj Mbledhje e Kryesisë së LK-së së Kosovës në të cilin u diskutua programi i veprimit të tyre.

12 maj 4 milicë u vranë dhe 3 u plagosën gjatë një rrethimi në një shtëpi në fshatin Prekaz i Poshtëm në Kosovë. 2 persona "të nxjerrë jashtë ligjit" u vranë. Deklaratë nga Franjo Herljević në Ditën e Sigurisë. Prishtinë 22.00 Studentët okupuan 4 konvikte studentësh në Qendrën e Studentit dhe bërtisnin e fishkëllenin. Ata hidhnin jashtë dritareve letra dhe gazeta të ndezura. Më vonë rreth 150 studentë okupuan zonën ndërmjet konvikteve, hodhën shishe dhe thërrisnin parullat "Kosova Republikë", "Poshtë spiunët". Demonstrata u shpërndamë rreth orës 03.00, më 13 maj, pas diskutimeve midis studentëve dhe qytetarëve.

14 maj Ambasadori shqiptar mori një "Aide Memoire" nga zëvendësministri i Jashtëm për "ndërrhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë". Ambasada shqiptare u përmend nga Kalezić në një konferencë për shtyp.

18 maj 21.00 Rreth 1 000 studentë demonstruan në Qendrën e Studentit në Prishtinë duke thirrur parulla. Si rezultat, u vendos që të mbyllej viti shkollor në universitet, d.m.th. 10 ditë më herët. Zëvendëskryetari Pajazit Nushi, dhe Imer Jaka, anëtar i Këshillit Ekzekutiv, përgjegjës për kulturën dhe arsimin, paraqesin dorëheqjen e tyre.

19 maj Pejë 19.00 20-30 studentë nga Shkolla e Lartë Tregtare kërcyen vallen "Kola" dhe kënduan këngë nacionaliste përballë konviktit. Kur po nxirreshin jashtë nga kjo zonë, ata përshëndetën me grusht duke thirrur "Duam Republikë, me mjete paqësore ose me luftë".

20-22 maj Sulm në "shtypin kryesor" nga profesorë të Universitetit të Prishtinës. Gazeta "Politika" përgjigjet.

21 maj Një grup prej 6 studentësh filluan të thërrisnin parulla në stacionin e autobusit.

23 maj Dy pajisje të vogla eksplozive shpërthyen jashtë ndërtesës së Ambasadës jugosllave në Tiranë.

24 maj Ambasadori jugosllav në Tiranë proteston para autoriteteve shqiptare.

27 maj Ambasadori shqiptar në Beograd u thirr në SFPJ - mbledhje e Kryesisë së KQ-së të LK-së së Serbisë.

28 maj Kryesia e LK-së së Kosovës konfirmoi programin e saj të veprimit. Nga data 11 deri më 20 maj, u përjashtuan 440 anëtarë të LK-së së Kosovës. Culafiç, sekretar i LKJ-së, mbështeti rolin e shtypit në ngjarjet e Kosovës.


29 maj Franko Herljević, sekretari Federativ për Punët e Brendshme, viziton Kosovën.

Mbledhje e Sindikatave të Kosovës.



# A është e drejtë të botohet romani i fundit i Márquezit?

*I ndjeri Márquez kishte shprehur dëshirën që dorëshkrimi të mbetet i fshehur – por edhe historia ka të drejtën e saj*



Nga: Erica WAGNER /  
*Financial Times*  
Përktheu: Granit ZELA

Kur ishte gjallë, Gabriel García Márquez vendosi që romani i tij i fundit të mos botohej. Shkrimtari kolumbian – një nga më të mëdhenjtë e shekullit të 20-të, autor i *Njëqind vjet vetmi* dhe fitues i çmimit Nobel në 1982 – kishte vuajtur nga demenca, megjithëse vazhdonte të punonte. Pas vdekjes në vitin 2014, në moshën 87-vjeçare ky dorëshkrim i fundit iu bashkua arkivit të tij në Qendrën *Harry Ransom* në Universitetin e Teksasit, duke u mbajtur larg syve të publikut, në përputhje me vullnetit e shprehur. Megjithatë, 10 vjet pas vdekjes, libri i titulluar *Shihemi në gusht* [*En Agosto Nos Vemos*] do të botohet në të gjithë botën më 6 mars. Djemtë e tij, Rodrigo dhe Gonzalo García Barcha, kundërshtuan kërkesën e babait të tyre. *Shihemi në gusht* ishte

fryt i përpjekjes së fundit të babait tonë për të vazhduar të krijojë duke bërë të pamundurën,” kanë thënë ata. Duke e lexuar romanin, bijtë zbuluan se pavarësisht nga ndonjë mangësi – ai ende pasqyrore “aftësinë e tij për të trilluar, gjuhën poetike, rrëfimin magjepsës, botëkuptimin për njerëzimin dhe dashurinë për përvojat dhe fatkeqësitë tona”. A kanë të drejtë trashëgimtarët të shpërfillin dëshirën e tij? A është botimi i librit një shenjë mosrespektimi apo (siç pëshpëritet) dëshmi e dëshirës për të fituar para? E thënë shkoqur, mund të themi se nuk ka fare rëndësi: Domethënia e García Márquezit shkon përtej përkujdesit apo dëshirave të tij të fundit. Ky është kuptimi i vdekjes për ju. Ne të tjerët, lexues dhe studiues të letërsisë dhe neuroshkencës, do të kemi tani një shans jo vetëm për ta lexuar këtë vepër të fundit, por edhe për të kuptuar pak, ndoshta, se si sëmundja e tij shkatërruese ndikoi në fuqinë

krijuese. Krahasimi mund të bëhet me librin e mrekullueshëm të shkrimtarit amerikan, David Milch, “Puna e një jete”, i sapobotuar. Ai përbën një guidë për procesin e krijimit të këtij autori: por pasqyron edhe dëmin e demencës tek ai dhe është shkruar me ndihmën e bashkëshortes dhe fëmijëve. Trashëgimia e një autori nuk ngurtësohet asnjëherë; dhe është e rëndësishme të theksohet se një libër me pak i rëndësishëm, nëse do ta gjykojmë kështu, nuk do të ndikojë në reputacionin e një libri më të madh. Libri i fundit që García Márquez botoi gjatë jetës, *Kujtime kurvash të trishtata* (2004) nuk u prit shumë ngrohtë: “Një ushtrim me gjysmë zemre i artit të rrëfimit, i botuar thjesht për të sh;nuar kohën”, shkroi shënimin hidhërek Michiko Kakutani në *The New York Times*. Megjithatë, pjesa tjetër e vepërës mbetet e pazbeher dhe e qëndrueshme; dhe ajo që është e vogël mund të hedhë dritë mbi të madhen.

Romani i Harper Lees, *Shko vër një rojë*, u botua në vitin 2015, një vit para vdekjes, dhe dukej e paqartë se sa e përfshirë kishte qenë në botim: megjithëse edhe pse nuk ishte botim pas vdekjes, ngjante si i tillë. Deri në atë moment ajo kishte botuar vetëm një libër, dhe një nga më të njohurit e shekullit të 20-të – fitues i çmimit Pulitzer, *Të vrasësh zogun pëqeshës*, në vitin 1960.

*Shko vër një rojë* është vepër e vogël; megjithatë hedh dritë në *Të vrasësh zogun pëqeshës* – jo vetëm sepse, në shekullin e 21-të, rrëfimi i të bardhit shpëtimtar në roman është shumë më problematik. Ai zbuloi se Atticus Finch – i perceptuar deri më tani si një nga figurat më të mëdha morale të letërsisë amerikane – kishte marrë pjesë në një takim të Kju Klus Klanit në rininë e vet; dhe se ai mendonte se përpjekjet për të zhdukur skllavërinë në Jug po ecinin me ritme shumë të shpejta. Kur u publikua lajmi – dhe ishte një lajm i madh – im

bir, atëherë 14-vjeçar kishte telefonoi nga shkolla: “Mami, a është Atticus Finch racist?” “Shko vër një rojë”, tregon se Finch nuk mund të shmangte të qenit një njeri i kohës së tij. Franz Kafka i kërkoi Maks Brodit, të kthehej në ekzekutuesin e vepërës së tij letrare, t’ia digjte pas vdekjes letrat: po të kishte pranuar Brodi, ne nuk do të kishim *Kështjella* ose *Gjyqi*. Ted Hughes shkatërroi disa nga ditarët e Sylvia Plathit: një akt mbrojtjeje apo përdhosjeje? Në njëqindvjetorin e lindjes së JD Salingerit, në vitin 2019, i biri, Matt Salinger më tha mua – dhe botës – se ai synon të nxjerrë dalëngadalë vepërën e pabotuar të të atit.

A do të revolucionarizohet të kuptuarit tonë për këtë autor? Nuk ka gjasa, megjithëse ideja se do të botohen ato vepra pa asnjë dyshim është magjepsëse. A është zhvlerësuar kujtimi i Salingerit nga i biri? Unë mendoj se jo. Ne mund të lumturohemi, sigurisht, kur njohuritë tona për vepërën e një artisti zgjerohen.



Shkruan: Kudusi LAMA














**EURO GLASS**  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 345 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



# Drita shënon fitore të madhe ndaj Feronikelit, Prishtina deklasoi Dukagjinin



**Veton ZYMBERI**

**PRISHTINE, 14 MARS** - Të enjten janë zhvilluar edhe dy ndeshjet e fundit të javës së 25-të në Superligën e Kosovës në futboll. Skuadra e Dritës e ka shfrytëzuar për mrekulli gabimin e Ballkanit dhe Llapit, pasi ka shënuar fitore ndaj Feronikelit 74 (0-1) dhe në këtë mënyrë i është afruar në një, përkatësisht dy pikë skuadrave kryesuese. Pjesa e parë e kësaj ndeshje përfundoi 0-0, ani pse rastet nuk munguan. Pjesa e dytë ishte edhe më interesante dhe më shumë raste shënimi, derisa mysafirët e gjetën golin e fitores dhjetë minuta pa përfunduar ndeshja me anë të Rady Ovouka. Pas kësaj xhiroje, "Nikli" është në vendin e shtatë me 26 pikë, kurse Drita është e treta

me 49 pikë. Në ndeshjen tjetër të zhvilluar në stadiumin "Sami Kelmendi" në Lipjan, Prishtina e ka deklasuar skuadrën e Dukagjinit, pasi e ka mposhtur me rezultat 5-0. Në pesë minutat e parë kryeqytetasit shënuan dy gola të shpejtë nëpërmjet Limanit dhe Peqelit. Ky i fundit realizoi edhe golin e dytë personal dhe të tretin në ndeshje në fund të pjesës së parë nga penalltia. Në pjesën e dytë, Hamiti realizoi dy gola për ta kompletuar fitoren bindëse të Prishtinës me rezultat 5-0. Me tri pikët e reja, Prishtina është ngritur në kuotën e 37 pikëve dhe renditet në pozitën e pestë. Dukagjini renditet një pozitë më poshtë dhe ka 31 pikë. Kampioni në fuqi dhe kryesuesi i elitës, Ballkani, të mërkurën pësoi humbje me rezultat 2-0 nga Fushë-

Kosova. Këtë humbje të Ballkanit nuk e shfrytëzoi Llapi që, po ashtu, pësoi humbje nga Malisheva (2-0). Fitore të rëndësishme në garë për mbijetesë ka realizuar Gjilani ndaj Lirisë me rezultat bindës 3-0.

SUPERLIGA	
Prishtina - Dukagjini	5-0
Feronikeli 74 - Drita	0-1
Fushë Kosova - Ballkani	2-0
Gjilani - Liria	3-0
Malisheva - Llapi	2-1
Tabela	
1. Ballkani	25 51
2. Llapi	25 50
3. Drita	25 49
4. Malisheva	25 44
5. Prishtina	25 37
6. Dukagjini	25 31
7. Feronikeli 74	25 26
8. Gjilani	25 25
9. Fushë Kosova	25 19
10. Liria	25 10

## SHKURT

### Varrosët në Gjermani ish-boksieri Besar Nimani

Të enjten i është dhënë lamtumira e fundit ish-boksierit të Kosovës, Besar Nimani, i cili ditë më parë është vrarë në Gjermani. Ai u varros në varrezat e myslimanëve në Bielefeld të Gjermanisë. Besar Nimani u qëllua më 9 mars në Gjermani dhe, pas plagëve të marra, vdiq. Dy personat që dyshohet se janë dorasit janë shpallur në kërkim nga policia e Gjermanisë. Emrat e tyre janë: Ayman Dawoud Kirit dhe Huseyin Akkurt.

### Konfirmohet ftesa e Kosovës për Rrahmanin

Sulmuesi Albion Rrahmani është thirrur në Përfaqësuesen e Kosovës në Futboll për herë të parë pas lëndimit që pësoi në ndeshje me Andorrën. Lajmin e ka konfirmuar skuadra e tij Rapid përmes një postimi në faqen zyrtare. Kosova do t'i zhvillojë dy miqësore me Armeninë (22 mars) dhe Hungarinë (26 mars). Rrahmani ka dy ndeshje në përfaqësuesen deri më tani.

### Kosova e pranoi dhe e dorëzoi stafetën e famshme të Lojërave Olimpikë

Pranimin e stafetës për promovimin e Lojërave Olimpikë Paris 2024, në kuadër të kampanjës së Ambasadave të Francës nëpër botë, Ambasada e Francës në Kosovë dhe KOK-u e bënë në shtëpinë e kampionëve tanë olimpikë, Qendrën Nacionale të Xhudos në Pejë. Pjesëmarrës të kampanjës ishin presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, ambasadori Olivier Guerot, kampionet olimpikë Distria Krasniqi dhe Majlinda Kelmendi, trajneri i tyre Driton Kuka dhe ekipi i xhudos. "Faleminderit Lituani! Po e marrim stafetën këtu në Kosovë. Në Qendrën Kombëtare për stërvitjen e ekipit të xhudos", u shpreh ambasadori Guerot.

### Zvicra fton tre shqiptarë për miqësoret e marsit

Kombëtarja e Zvicrës ka publikuar listën e lojtarëve të ftuar për dy miqësoret e marsit. Në mesin e të ftuarve janë edhe tre shqiptarë, Granit Xhaka, Xherdan Shaqiri dhe Uran Bishlimi. Ky i fundit më parë kishte luajtur edhe për Kosovën, ku kishte zhvilluar dy ndeshje miqësore, teksa kishte shënuar edhe një gol. Zvicra fillimisht do të përballet me Danimarkën më 23 mars në Kopenhagë, tre ditë më vonë me Irlandën në Dublin. Kombëtarja zvicerane ka bërë me dije se më 7 qershor do ta publikojë listën zyrtare të lojtarëve për Kampionatin Evropian që do të mbahet në Gjermani.

## Munishi: Futbolli i Kosovës është në krizë

**PRISHTINE, 14 MARS** - Trajneri Ismet Munishi ka thënë se futbolli i Kosovës është në krizë. Ai në "Facebook" ka listuar disa probleme që, sipas tij, po e mundojnë këtë sport në Kosovë duke ia humbur hijeshinë dhe entuziazmin që futbolli duhet ta ketë. Ai ka thënë se në kohët e fundit ka humbur përkushtimi i klubeve ndaj tifozëve dhe se ata po mashtrohen sepse gjithçka po

bëhet për para. "Pjesa më e rëndësishme e futbollit janë tifozët, kur ata të shkojnë nga stadiumi të jenë të lumtur. Është koha dhe dashuria që ata i kushtojnë klubit të zemrës, ndërsa ti si aktor duhet t'i kënaqësh ata dhe t'i bësh të lumtur", ka shkruar Munishi. Ai ka shtuar se është paraja ajo që është bërë elementi më i rëndësishëm në të gjitha sferat e futbollit duke nisur që nga dhomat

e veshjeve. "Ndërsa tash jetojmë në kohën kur askush nuk flet për këto tema nga sportistet, e tifozët e ndjejnë dashurinë por edhe mashtrimin, flitet vetëm për para, para, para, para. Parë në zhveshtore, para në studio, para gjithandej. Tifozë pak, Futboll edhe më pak, Burrëri zero gjithandej, integritet minus zero. Futbolli Kosovës në krizë", ka shkruar Munishi.



## Ndeshje interesante në çerekfinale të Kupës

Prishtinë, 14 mars - Ndeshje interesante do të zhvillohen në çerekfinale të Kupës së Kosovës në konkurrencë të meshkujve. Ndeshjet zhvillohen më 20 e 21 mars. Fituesja në fuqi e Kupës, Trepça, llogaritet favorite në "Minatori" ndaj Deçanit.

Prishtina - Kastrioti pritet ta ofrojë rivalitetin më të madh. Prishtina së fundi luajti ndeshje të fortë me Besa Famgas dhe synon rritje të formës në vazhdim të garave. Ndërkohë Kastrioti ka bërë përf forcime të shumta dhe synon trofetë.

Lideri, Rahoveci, vlerësohet ndaj ndeshjen në udhëtimin ndaj Vushtrrisë, derisa Besa Famgas do të sfidohet në Pejë nga rivali regional, Vëllaznimi. Është tërhequr shorti edhe në konkurrencë të femrave. Ndeshjet zhvillohen më 20 e 21

mars, ndërsa janë disa sfida interesante. Fituesi në fuqi i Kupës dhe kampioni aktual, Istogu, do të sfidohet nga Prishtina në kryeqytet. Samadrexha e pret Kastriotin, ndërsa Vushtrria luan si vendase ndaj Jusuf Gërvallës.



Ndeshje e fortë pritet të jetë edhe ajo që luhet në Gjakovë në mes të Shqiponjës dhe Ferizajt.

## 'FC Besa Peja' kompletton ekipin teknik, klubi me synime të mëdha

**PEJE, 14 MARS** - Klubi i Futbollit KF Besa Peja ka angazhuar ekipin teknik dhe kryetrajnerin për ekipin e meshkujve të cilët do të angazhohen në mënyrë që ta mbledhin ekipin e lojtarëve për ta filluar sezonin 2024/25.

Ekipi i mbledhur do të kyçet në Ligën Rajonale dhe nga aty synon Superligën e Kosovës dhe, në fund, daljen në Evropë, raporton "RADIO 1".

Bordi i përkohshëm i ekipit, i cili është i përbërë nga profesionistë të fushave të ndryshme, i kanë dhënë besimin e plotë profesional ekipit teknik, duke u tërhequr vetëm në çështjet e menaxhimit të klubit që nuk kanë të bëjnë me çështje drejtpërdrejt sportive. Trajneri dhe ekipi teknik i meshkujve do të jenë përgjegjës për rezultate përdorura kompozimi i ekipit do të jetë plotësisht në diskresionin e këtij ekipi trajnerësh në kuadër të buxheteve të ofruara nga bordi dhe kuvendi. Trajneri Fisnik Gashi me një përvojë të gjatë dhe rezultate të mira në ligat e Kosovës ka marrë këtë punë për një afat të gjatë dhe planet e tij janë afatgjatë. "Nuk është me rëndësi në cilën ligë fillojmë. Me rëndësi është ku synojmë të arrijmë. Unë kam parë organizim të mirëfillte, njerëz seriozë që kanë vendosur qëllime afatgjatë", ka thënë Gashi.



Ai ka qenë trajner i Klubit "Besa" në ligën e parë të Kosovës, ka qenë trajner i Istogut, gjithashtu në këtë ligë, me të cilin janë arritur rezultate më të larta sesa janë pritur. Gjithashtu, në qytetin e Pejës ai ka punuar me Klubin "Rilindja". Për Gashin, "Besa Peja" do të jetë ekip i promovimit të talentit të futbollit në Pejë dhe rrethinë, ku secili futbollist i këtij rajoni do ta dijë se ka një ekip ku mund të promovohet. "Ne tashmë kemi filluar skauting dhe të gjithë lojtarët do të inkuadrohen në ekip për afat të gjatë, pra kontrata dy-tre vjeçare. Ekipi gjatë kohës do të plotësohet me lojtarë të tjerë, por do të ketë një grup bazë të planifikuar në

mënyrë afatgjatë", ka shtuar ai. Edhe kryetari i Bordit, Ardet Zekaj, ka folur për emërimet. "Jemi të lumtur që kemi Fisnin në ekip. Kemi punuar që të zgjedhim më të mirin dhe kemi parë që Fisi na ka ofruar vizionin e duhur dhe e ka marrë punën pa paragjykim se ku po fillojmë. Ai e ka besimin tonë të plotë", ka thënë Zekaj. Klubi "Besa Peja" është themeluar nga 100 dashamirë të futbollit të Pejës dhe ata kanë dhënë zotime që për pesë vitet e ardhme ta financojnë klubin. Është ekipi i parë në Kosovë që është krijuar me metodën "Crowdfunding". Në këtë mënyrë klubi do ta ketë në vete gjithëpërfshirjen dhe stabilitetin.

## Denveri fiton sfidën për titull ndaj Miamit

**MIAMI, 14 MARS** - Denveri mposhti me rezultat 100-88 Miamin në përballjen në mes të dy ekipeve pretendent për titull në NBA. Porter me 25 pikë mori rolin e liderit në këtë sfidë për miqtë, lojtar që mungoi te skuadra e Miamit. Ekipi i Sacramentos, falë "triple double" të Sabonis (17 pikë, 19 rebounde, 10 asistime), mundi 120-107 lakersat. Të gjithë titullarët e Kingsit realizuan mbi 14 pikë, duke i bërë të pavlefshme 28 pikët e Reaves për miqtë. Pas kohës shtesë fiton Chicago, që mundi me rezultat 132-129



Indianan, ndeshje ku u dallua DeRozan me 46 pikë. Skuadra e Dallasit mundi me rezultat 109-99 Golden Staten, ndeshje ku

dyshja Irving - Donçiq realizoi 44 pikë së bashku. Fitoi edhe Orlando, 114-106 ndaj Brooklynit, me 7 lojtarë që realizuan mbi 10 pikë.

### REZULTATET

Detroit - Toronto	113-104
Orlando - Brooklyn	114-106
Indiana - Chicago	129-132
Miami - Denver	88-100
Memphis - Charlotte	98-110
New Orleans - Cleveland	95-116
Dallas - Golden State	109-99
Portland - Atlanta	106-102
Sacramento - Lakers	120-107

## Sancho: Krenar për golin dhe kualifikimin, i jam mirënjohës klubit dhe tifozëve

Borussia Dortmund preu një biletë për në çerekfinale të Ligës së Kampionëve pas fitores 2-0 ndaj PSV në Gjermani. Një sukses që mban edhe firmën e mesfushorit anglez Jadon Sancho, që shënoi golin e parë të ndeshjes pas vetëm

tre minutash lojë. I rikthyer te Borussia në janar, lojtari duket se po rigjen formën e dikurshme. Ai u zgjodh edhe MVP i sfidës. "E dimin se do të ishte e vështirë, por gjithmonë kishim avantazhin sepse ishim përballë

tifozëve vendas", u shpreh Sancho. "Nga fjalimi i skuadrës në dhomat e zhveshjes, e dija se mund ta bënim realitet kualifikimin. Ne i qëndruam besnik planit tonë të lojës nga minuta e parë deri në të fundit. Jam i lumtur për fitoren", ka

thënë anglezi për TNT Sports. Duke folur për golin e tij, Sancho ka shtuar: "Ishte si një lehtësim. Thjesht doja ta nisja mirë ndeshjen dhe nuk ka ndjenjë më të mirë se kjo. Jam mirënjohës që kam shënuar golin për ekipin.

Kam pasur gjithmonë një ndjenjë të veçantë me Borussia Dortmundin. Këtu bëra emër disa vjet më parë dhe doja të rikthehesha. Duhet t'u jem mirënjohës atyre dhe shokëve të skuadrës që besuan në mua".

### SHKURT

#### Empoli publikon diagnozën e Ismajlit, në dyshim për miqësoret e marsit

Arrian Ismajli ishte i pafat në ndeshjen e fundit të Serisë A të Empolit ndaj Milanit pasi u detyrua ta braktiste fushën e lojës në fundin e pjesës së parë për shkak të një dëmtimi. Së fundmi, klubi i Empolit publikoi edhe raportin mjekësor sa i takon mbrojtësit të kombëtares. Në raport bëhet me dije se 27-vjeçari vuan një dëmtim muskolor në kofshën e këmbës së djathtë, teksa klubi në njoftimin zyrtar thekson se tashmë Ismajli ka nisur fazën e rikuperimit. Në raportin e Empolit nuk bëhet me dije periudha që do të mungojë Ismajli teksa impenjimi i radhës për këtë skuadër është ndaj Bolognas. Mbetet për t'u parë nëse Ismajli do t'ia dalë të rikuperohet në kohë për këtë ndeshje teksa në horizont janë edhe dy miqësoret me Shqipërinë ndaj Kilit dhe Suedisë më 22 dhe 25 mars.

#### Simeone: E meritum fitoren ndaj një skuadre shumë të fortë

Trajneri i Atletico Madridit, Diego Simeone, është shfaqur i lumtur pas kualifikimit për në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. Atletico eliminoi Interin e fortë të Simone Inzaghit falë penalltive, pasi Oblak dhuroi spektakël te 11-metërshat me pritjet e tij. "Jam shumë i lumtur për tifozët, lojtarët dhe njerëzit tanë. E meritum fitoren ndaj një skuadre shumë të fortë. Dësh vdiq kur Riquelme humbi atë rast, por ne i besuam penalltinë e rëndësishme në fund. U përqendrua dhe shënoi. Kështu është edhe jeta, nuk fiton i njëjti person gjithmonë. Vinim nga dy humbje të rënda, por kam djem me zemër të madhe. Pastaj, tifozët tanë janë të jashtëzakonshëm. Nuk është e thjeshtë të përballesh me ne në këtë stadium", ka thënë Simeone.

#### Inzaghi: Humbja na lëndon, e kishim në dorë kualifikimin

Trajneri Simone Inzaghi ka pranuar se Interi nuk ishte mësuar të humbiste dhe se ishte krenar për lojtarët e tij. Tekniku zikaltër gjithashtu thekson se humbja dhemb dhe se skuadra e tij e kishte në dorë kualifikimin. "Ka zhgënjim për klubin dhe gjithë familjen e Interit, por u thashë djemve se duhet të jenë krenarë për udhëtimin që kanë bërë. Ne ishim të pamposhtur në tetë ndeshje, por duhet të kishim bërë më mirë. E kishim ndeshjen në dorë, bëmë shumë gabime dhe kjo bëri diferencën. Mund të kishim bërë më shumë në ndeshjen e parë, por këtu duhet të kishim mbajtur epërsinë që na dha Dimarco", ka thënë Inzaghi. "Kjo skuadër nuk është mësuar të humbasë. Humbja duhet të lëndojë. Ne e kishim kualifikimin në dorë. Megjithatë, jam super krenar që jam trajner i kësaj skuadre. Është zhgënjyese për të gjithë ne, por tani kemi 10 ndeshje përpara në Serinë A dhe duhet të përpiqemi t'i fitojmë për ta arritur objektivin më të rëndësishëm", ka shtuar Inzaghi.

Njoftim për zvogëlimin e kapitalit të përgjithshëm të Shoqërisë "Jakova-L", Sh.P.K

Shoqëria Tregtare "Jakov-L", SH.P.K., me numër NUI: 810611849, me seli në Gjakovë, në mbështetje të Nenit 147, paragrafi 3 të Ligjit nr. 06/L-016, për Shoqërinë Tregtare, lëshon këtë:

### NJOFTIM

Kuvendi i Aksionarëve, në mbledhjen e përgjithshme të datës: 10.03.2024, ka vendosur për zvogëlimin e kapitalit të përgjithshëm të Shoqërisë "Jakova-L", SH.P.K., ashtu që kapitali i përgjithshëm i Shoqërisë do të jetë nga; 1,642,533.70 € me 164,253 aksione me vlerë nominale 10 €, në 2,500 €, me 250 aksione, me vlerë nominale prej 10 € për aksion. Pjesëmarrja e aksionarëve në pronësi nuk do të ndryshojë.

Ky njoftim publikohet me qëllim të njoftimit të kreditorëve të mundshëm të Shoqërisë, në zbatim të Nenit 147 të Ligjit nr. 06/L-016, për Shoqëritë Tregtare.

Gjakovë, 10.03.2024

"Jakova-L", Sh.P.K.

NUI: 810611849.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Solarium Center Prishtina" Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811487570 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Solarium Center Prishtina" D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811487570 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Solarium Center Prishtina" L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 811487570 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Krenare Shala nga Rogova KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesëne kl. 10.11.12. dhe diplomën e Gjinnazit "Asllan Berisha" Rogovë KK Gjakovë.

- Dardan Bajrami nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. të sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Valmir Rragamaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl.10.11.12. të sh.m. teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Alban Selimi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Gjin Gazulli" Prishtinë.

- Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjejpuneshejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshejte)

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË